

VENDIM
Nr.592, datë 5.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA SHTETËRORE TË
VENDIT, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË EDHE PAS LIRIMIT NGA FUNKSIONI¹

(Ndryshuar me VKM nr.428, datë 17.5.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Garda e Republikës së Shqipërisë do të ruajë dhe mbrojë pas liritimit nga funksioni, edhe këto personalitete të larta shtetërore:

- Prokurorin e Përgjithshëm;
- Ministrin e Brendshëm.

2.*Personalitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ruhen dhe mbrohen me oficer e nënoficer shoqërues edhe 2 (dy) vjet pas liritimit nga funksioni.*

3.Vendimet nr.310, datë 14.5.2004 dhe nr.93, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

4.Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ VKM nr.592, datë 5.9.2007 është botuar në Ekstra nr.58, korrik 2010.
VKM nr.428, datë 17.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.117, 23 maj 2017.